



## Departamenti i Prokurimit

Prishtinë: datë, 03.12.2019

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 30.11.2019 të parashtruar nga Operatori Ekonomik "Integral SHPK" për aktivitetin: "Mirembajtja dimerore e rrugeve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7786-211 nxjerr:

### VENDIM

**Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik "Integral SHPK" e datës 30.11.2019 lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirembajtja dimerore e rrugeve rurale" dhe me numër të prokurimit: 616 -19-7786-211 kundër *Njoftimit të Vendimit për dhënje të kontratës të AK – së*, të datës 25.11.2019, të publikuar në Platformën elektronike E Prokurimi të KRPP-së.

1. Vertetohet *Njoftimi i Vendimit* i publikuar me datë: 25.11.2019 dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon aktivitetin sipas te njejt;
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

### Arsyetim

Operatori Ekonomik "Integral SHPK" me datë 30.11.2019 ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me rivlerësimin e aktivitetit të prokurimit me titull: "Mirembajtja dimerore e rrugeve rurale" dhe me numër 616 19 7786-211.

Autoriteti Kontraktues, me datë 02.12.2019, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë dhe ka konstatuar si vijon:

- Pretendimi se OE-ik "Dardania" i rekomanduar për kontratë për lotin 1 nuk ka deshmuar se posedon ngarkues të medhenje është i pa bazuar, pasi që nga deshmite e dorëzuara në oferte është konstatuar se ka deshmim për tre ngarkues (Faun F 1110, O&K MH6 dhe Liebherr 507) dhe se pesha nuk është limituar në FDT;
- Pretendimi se Autoriteti Kontraktues nuk ka pasë të drejtë të kërkojë sqarime shtese është paashtu i pa bazuar, pasi që kjo është e drejtë ligjore sipas nenit 72 të LPP-ik dhe

RRUOPP-se. Sqarimi i eshte kerkuar per faktin se ne deshmite e ofruara per posedimin e kamioneve specilal ka dorezuar deshmite per posedimin e nente kamioneve,por me libreza kane qene te shenuar veten tre prej tyre si automjete per largim te bores,ndersa deshmite per te tjeret jane dhene me foto dhe libreza ku nuk eshte shenuar destinimi i automjetit.Ne sqarimin e derguar ky tenderues ka bere modifikim per automjetin me regjistrim 01-374-NN,qe d.t.th.per automjetin qe e ka paraqitur ne oferte dhe qe nga fotoja shihet si automjet per pastrimin e bores.Duke u bazuar ne faktin se eshte fjala per automjetin e njejte komisioni e ka pranuar kete sqarim dhe modifikim si te arsyeshem.

-Lidhur me pretendimin se ka ofruar çmimi jonormalisht te ulta i sqarojme se sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet nuk eshte konstauar asnje oferte e as e tenderuesit "Dardania".

-Poashtu pretendimi se ky OE-ik nuk ka reference te pranueshme i sqarojme se referenca e dorezuar nga i njeiti eshte plotesisht e pranueshme dhe e verifikuar.

-Pretendimi se automjeti 01-328-HB nuk eshte automjet per largimin e bores eshte poashtu i pa bazuar pasi qe eshte automjet special sipas deshmise-librezes dhe poashtu i deshmuar me foto.

-Pretendimi per tenderuesin tjeter "VAAKAL" se nuk ka dorezuar deshmi per automjetet per largimin e bores poashtu eshte i pa qendrueshem,pasi qe i njeiti ne oferten e tij ka paraqitur pese kamion si kamion per largim te bores(01-156-IJ;01-157-IJ;01-618-CP;01-677-EF dhe automjetin e huazuar 01-924-LL),por ne librezat e qarkullimit dy prej tyre jane shenuar vetem si kamion dhe kjo ka qene arsyeja e kerkimit te sqarimeve shtese.Poashtu arsye tjeter per sqarime ka qene fakti se i njeiti per njerin ngarkues ka dorezuar nje fature ku shenon lloji i mjetit bager.

Pas sqarimeve eshte konstatuar se te gjitha kamionet jane te destinuar per pastrim te bores dhe modifikimet jane bere pa u ndryshuar asnje nga mjetet e paraqitura ne liste,respektivisht librezat jane me regjistrime te njehta dhe eshte ndryshuar vetem rubrika Ndertimi.

Poashtu lidhur me pretendimin se ngarkuesi OFKL eshte eskavator e jo ngarkues sqarojme se nuk eshte i bazuar,pasi qe me Deklarate unike doganore te dorezuar pas kerkeses per sqarim shkruan qarte se eshte ngarkues.

Vlen te cek se te gjitha sqarimet jane kerkuar ne harmoni me nenin 72 te LPP-ik.

-Pretendimet per tenderuesin tjeter Alko Impex&Bashkimi se ka çmime jonormalisht te ulta dhe se nuk ka dorezuar deshmi per ngarkues dhe freze si dhe nuk ka dorezuar liste te punetoreve jane poashtu te pa qendrueshme per arsyet ne vijim:

-Sipas Rregullave per tenderet jonormalisht te ulet nuk ka rezultuar asnje tender i trajtuar si i tille;

-nga deshmite e dorezuara te anetarit te grupit Alko Impex shihet se nga pese librezat e qarkullimit ku shenohen si eskavator,tre prej tyre jane ngarkues(2 te

markes JCB 4CX-SM dhe nje i markes JCB 3CXSM)dhe si sqarimet e pranuar deshmojne se lista e punetoreve eshte e njejta me deshmite e dorezuara ne tender dhe deshmia per freze eshte kerkuar sipas listes se dorezuar.Ua perkujtoj se te gjitha kerkesat per sqarime jane ne harmoni me dispozitat ligjore.


-Poashtu pretendimi se eshte dorezuar nje liste nga Bashkimi&Meti per paisje dhe se nuk jane deshmite nuk ka baze,pasiqe Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se deshmite e dorezuara nga anetari tjeter "Alko Impex"i plotesojne kerkesat nga FDT-ja dhe nuk ka pase nevojte te kerkohen deshmi tjera.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit duke u bazuar në konstatimet paraprake ka vendosur si ne dispozitiv dhe Autoriteti Kontraktues vazhdon proceduren sipas Njoftimit te dates 25 .11.2019.

**Këshilla juridike:**

Kundër këtij vendimi, pretenduesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. **Ankesa prane OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit ,



Vendimi u dërgohet:

- Palës ankuese(nepermes Platformes elektronike);
- Njesisë së kërkesës;
- Departamentit të Prokurimit;dhe
- Anëtarëve të komisionit